
KRIKË DHE BIBLIOGRAFI

RAMI MEMUHAJ**ENVER MUHAMETAJ, *MENDIMI LETRAR SHQIPTAR (1939-1944)*, INSTITUTI I GJUHËSISË DHE LETËRSISË, SHTËPIA BOTUESE “BOTA SHQIPTARE”, TIRANË, 2008**

Trashëgimia jonë kulturore, edhe pse është zhvilluar përmes ndalimesh e kufizimesh të shumta, ka ardhur duke u pasuruar me prurje të të gjitha fushave. Mirëpo, me kalimin e kohës, prodhimi i begatë kulturor i periudhave të mëparshme po vjen duke u bërë gjithnjë e më i vështirë për t’u gjetur e shfrytëzuar prej studiuesve, për shkak të shpërndarjes në botime e biblioteka të ndryshme. Kjo gjë e ka bërë një domosdoshmëri dhe një nevojë gjithnjë e më urdhëruese botimin e kësaj trashëgimie kulturore. Pikërisht, përmbledhja “Mendimi letrar shqiptar (1939–1944)” është një përpjekje për t’u përgëzuar e studiuesit E. Muhametaj për përmbushjen e kësaj kërkese.

Në planet krijuese të njëzet vjetëve të fundit këtij studiuesi, botimi i mendimit letrar përbën një nga zërat e rëndësishëm të veprimtarisë së tij. Vetë titulli i përmbledhjes tregon se është fjala për një projekt me përmasa e shtrirje të gjerë dhe jo një përpjekje për të mbledhur në një vëllim disa artikuj për të marrë ndonjë gradë a titull shkencor. Që fjala është për një sipërmarrje të menduar, këtë na e tregon, së pari, kufizimi kohor që shoqëron titullin, i cili paralajmëron se do të pasohet nga botime të tjera. Plani perspektiv i autorit është që në të ardhmen të na njohë me mendimin letrar të një periudhe më të gjerë kohore. Së dyti, për qëllimet serioze të autorit bindemi edhe më shumë kur shohim lëndën e këtij vëllimi, të organizuar në bazë parimesh tekstologjike të mirëmenduara.

Sikundër e tregon edhe titulli, në këtë përmbledhje janë përfshirë shkrime që i përkasin vetëm njërit prej llojeve të mendimit artistik shqiptar, mendimit letrar, duke kuptuar me këtë term mendimin e mirëfilltë historiko-letrar, mendimin kritiko-letrar dhe mendimin teoriko-letrar, me fjalë të tjera mendimin shkencor për letërsinë në tri degëzimet e tij kryesore. Por edhe nga këto fusha nuk është përfshirë gjithçka është botuar, por kryesisht ato studime, artikuj, recensione, shënime letrare, parathënie apo pasthënie të veprave letrare të botuara, polemika e debate

të zhvilluara mes studiuesve për probleme të ndryshme letrare etj. që përfaqësojnë vlerat më të spikatura e më të qëndrueshme të kohës kur janë botuar dhe që lejojnë të përftohet një përfytyrim sa më i plotë e i saktë për thelbin, karakteristikat dhe vlerat thelbësore të mendimit letrar shqiptar të kësaj periudhe.

Periudha që mbulon kjo përmbledhje është një nga më të trazuarat e historisë së Shqipërisë. Në përfytyrimin jo vetëm të njeriut të rëndomtë, po edhe të një specialisti të letërsisë, mendimi se mund të jetë shkruar kaq shumë për letërsinë në kohëra kaq të trazuara, duket tepër absurd. Por përmbledhja e vëllimshme e përgatitur nga Enver Muhametaj dëshmon të kundërtën. Qindra faqet e kësaj përmbledhjeje dëshmojnë se në atë periudhë mendimi letrar ka gëluar në një shkallë shumë më të lartë se në ato pak periudha të qeta që ka kaluar vendi ynë. Sigurisht, ky recension nuk ka për detyrë të merret me shkaqet e këtij paradoksi, detyrë që u takon historianëve të letërsisë dhe kulturologëve.

Nga shfletimi i materialit të bie menjëherë në sy se kjo përmbledhje antologjike dallon nga librat e këtij lloji të botuar deri tani në disa veçori. Dallon sepse bën objekt një periudhë të ngushtë kohe, vetëm 6 vjet. Shtrirja në disa shekuj krahasuar me kufizimin në një periudhë të ngushtë i ngjan dallimit mes një ekspedite shëtitëse dhe një ekspedite stacionare në arkeologji. E para ka si qëllim të zbulojë pikat e mundshme ku duhet kërkuar, kurse e dyta ka si qëllim ta studiojë në mënyrë shteruese një nga këto pika arkeologjike. Është e qartë se vlera e këtyre të fundit është më e madhe. Pikërisht, përqendrimi në një periudhë më të shkurtër kohe, që lejon një përfaqësim më të gjerë të autorëve dhe të shkrimeve të tyre, përbën një veçori tjetër të kësaj përmbledhjeje.

Dallimi tjetër është në tematikën e trajtuar në këtë vëllim. Antologjitë e tjera përfshijnë një gamë të gjerë: mendimin letrar, estetik dhe artin në përgjithësi; madje edhe letërsi, histori e sociologji etj. Ndërsa në përmbledhjen që po diskutojmë autori e ka ngushtuar tematikën, duke u marrë vetëm me mendimin letrar. Kjo i jep atij mundësinë t'i bëjë një paraqitje më shteruese kësaj tematike, që i nevojitet posaçërisht studiuesit të letërsisë. Edhe artikujt polemikë të përfshirë në nënndarjen IV/A. 1, 2, 3, të cilët, në vështrim të parë, të lënë përshtypjen sikur i kushtohen tërësisht një çështjeje gjuhësore, në të vërtetë merren me argumentimin e çështjes së periodizimit të letërsisë shqipe, ose, shprehur me fjalët e Namik Resulit, me çështjen e "pjesëtimit sistematik e metodik të kësaj. . . letërsie. Argumentet gjuhësore të sjella përdoren pikërisht në funksion të argumentimit e të ndriçimit të këtij problemi të mirëfilltë letrar.

Thellimi në një periudhë të ngushtë kohe i ka dhënë mundësinë autorit të përfshijë më shumë autorë dhe më shumë shkrime. Kështu, numri i autorëve të përfaqësuar arrin në rreth 61 dhe i shkrimeve në mbi 103. Kjo e bën këtë përmbledhjeje mjaft analitike. Do thënë që një punë të tillë mund ta bëjë vetëm një studiues që ka kaluar muaj dhe vite në biblioteka, që ka qëmtuar me durim gazeta e revista dhe që ka djegur duart duke shkruar të dhënat për burimet dhe autorët e shfrytëzuar, në mos edhe për kopjimin e materialeve, një punë që nuk mund ta bëjë dikush që nuk e ka këtë punë okupimin e tij kryesor. Vlerat e kësaj pune janë me të vërtetë të mëdha për studiues të fushave të kulturës kombëtare, në veçanti për studiuesit e letërsisë, pasi u jepet në dorë në një vëllim të vetëm gjithë ky material, që gjendet i shpërndarë në sa e sa gazeta e revista. Kjo është një ndihmë shumë e madhe për këdo që do të bëjë objekt letërsinë e kësaj periudhe, pasi kohën që do t'i duhej duke u rropatur nëpër biblioteka për grumbullimin e materialit faktik, ia ka kursyer dikush tjetër.

Por nuk janë këto të vetmet veçori të kësaj vepre, gjë që kuptohet më mirë kur shfleton antologjitë që përmendëm. Këtyre botimeve u mungon aparati shkencor dhe informacioni filologjik, që janë shumë të nevojshëm për ta orientuar lexuesin, sidomos lexuesin që i hyn me një qëllim të caktuar leximit të botimeve të tilla. Krahasuar me to, përmbledhja që po diskutojmë, ndryshon thellësisht. Ajo shoqërohet me një varg shtojcash e treguesish, që ia rritin shumë vlerat. Lënda e përmbledhjes është ndarë në 10 krerë, veç treguesve dhe bibliografive. Treguesi i lëndës i saj është mjaft i detajuar, çdo krye është ndarë në nënkrerë tematikë. Pastaj vijnë tri bibliografi: njëra “Bibliografi e lëndës së shfrytëzuar”, “Literatura kryesore e konsultuar” për përmbledhjen dhe “Bibliografia e mendimit letrar dhe estetik shqiptar”.

Në “Bibliografinë e lëndës së shfrytëzuar” përfshihen burime të marra nga Biblioteka Kombëtare, botuar në “Studime historike”. Nga periodiku shqip i periudhës 1939-1944 janë shfrytëzuar 30 revista dhe 21 gazeta. Për secilin organ jepen vitet e botimit dhe numrat e gjetur për çdo vit. Për çdo organ jepen numrat që janë gjetur nga autori dhe në kllapa katrore ato të gjetura nga P. Daka në bibliografinë e periudhës 1848-1944. Në mjaft raste, autori ka gjetur edhe numra të tjerë revistash e gazetash që mungojnë në bibliografinë e Dakës.

Kurse “Literatura kryesore e konsultuar” përfshin 49 vepra, tekste, monografi, antologji e përmbledhje studimesh.

Sipas mendimit tim, me një vlerë shumë të madhe është “Bibliografia e mendimit letrar dhe estetik shqiptar të periudhës 1939-1944”. Vlera e saj qëndron në atë që studiuesve, jo vetëm të letërsisë, po edhe estetëve, madje edhe gjuhëtarëve, u jepet një ndihmë shumë e madhe që ua shkurton tepër kohën për kërkime bibliografike në arkiva e biblioteka për këtë periudhë, kërkime që sot janë bërë shumë të vështira, për të mos thënë gati të pamundura.

Në të tria bibliografitë jepen të dhëna të hollësishme për çdo artikull, duke treguar burimin nga është marrë, vendin dhe vitin e botimit, si dhe faqet, gjë që në antologjitë e tjera nuk bëhet në mënyrë sistematike ose mungon fare.

Aparati shkencor e bën këtë material një vepër që i kapërcen përmasat e një përmbledhjeje të thjeshtë dhe i jep pamjen e një krestomacie analitike. Shënimet e referimet e shumta të kësaj vepre janë dyfarëshe: shënime me të dhëna për autorin, për artikullin e veprën, për rrethana të tjera, për burimin nga është marrë materiali dhe shënime filologjike, në të cilat shpjegohen fjalë që nuk gjenden në fjalorët e shqipes së sotme, si dhe fjalë e shprehje të huaja të përdorura nga autorët e artikujve që përfshin përmbledhja. Për të shpjeguar këto, autori ka shfrytëzuar 39 fjalorë: 15 fjalorë të përgjithshëm e krahinorë të gjuhës shqipe, 10 fjalorë specialë dhe enciklopedikë në gjuhën shqipe, 7 fjalorë njëgjuhësh e fjalorë enciklopedikë në gjuhë të huaja dhe shtatë fjalorë dygjuhësh gjuhë e huaj – shqip.

Ky aparat shkencor i detajuar, që pothuajse mungon fare në antologjitë e mësipërme, ia shton shumë vlerat kësaj përmbledhjeje, pasi e bën atë të lexueshme edhe nga një jospecialist. Si gjuhëtar, vlerësoj tepër sidomos informacionin leksikor që jepet në shënimet. Veç pseudonimeve të autorëve, shpjegohen kuptimet e fjalëve dhe të termave të përdorur në tekstet, tregohet se si duhen lexuar trajta fjalësh që nuk janë në përputhje me normën gjuhësore. Janë me qindra e qindra terma të huaj, të cilëve autori u ka shpjeguar jo vetëm kuptimin e përgjithshëm, por edhe kuptimin e veçantë me të cilin janë përdorur në artikujt e përmbledhjes. Po edhe me më shumë vlerë janë njësitë leksikore të shqipes që nuk gjenden në fjalorët e sotëm. Për të gjetur kuptimet e tyre, autori ka qëmtuar nëpër fjalorët krahinorë të gjuhës shqipe. Është një lëndë gjuhësore me mjaft interes për leksikografinë, e cila mund të vlerësohet më mirë pas botimit të përmbledhjes.

Duke përfunduar, mund të themi se kjo antologji përbën një prurje me vlerë në fushën e njohjes së trashëgimisë sonë letrare, që do të

ndihmojë në thellimin e studimeve të mendimit letrar shqiptar dhe të letërsisë shqiptare të kësaj periudhe. E hartuar me një akribi shkencore të lavdërueshme, që përbën një karakteristikë të punës së autorit, kjo vepër përmban vlera edhe për metodologjinë e hartimit të përmbledhjeve të kësaj natyre. Si e para antologji e mbështetur në parime të rrepta të tekstologjisë, ajo do të shërbejë edhe si një shembull e model për vepra të këtij lloji. Tematika e hollësishme, bibliografia shumë e pasur, aparati shkencor dhe informacioni filologjik mjaft i nevojshëm sidomos për lexuesin e thjeshtë, do ta bëjnë këtë vepër jo vetëm shumë të dobishme, po edhe shumë të kërkuar.

